



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", ish - hotel "Drini", Tiranë

Tel: 04 2268141; 04 2268142

Nr. 304/6 Prot.

Tiranë, më 06.12.2017

**V E N D I M**

**Nr. 237, datë 06.12.2017**

**Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Devoll dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me procesin e mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, të zhvilluar në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Devoll,

**Vërej se:**

Me vendimin nr. 94, datë 25.04.2017, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Devoll", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme në këtë subjekt.

Objekti i mbikëqyrjes përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, e në vijim.

Pas riorganizimit administrativo-territorial të ndodhur në vitin 2015 në organet e qeverisjes vendore, organizimi dhe funksionimi i tyre, rregullohet me ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore".

Në përmbajtjen e këtij ligji, përcaktohen funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e njësive të qeverisjes vendore, që janë bashkitë dhe qarqet dhe konkretisht në nenin 5, të tij, *bashkia* përkufizohet si, "njësi bazë e vetëqeverisjes vendore, që përfaqëson një unitet administrativo-territorial dhe bashkësi banorësh, ku shtrirja territoriale, emri dhe qyteti qendër i saj, përcaktohen me ligj".

Më tej, në nenin 6 dhe 65, të ligjit në fjalë, përcaktohet se, *“Bashkia përbëhet nga disa njësi administrative, sipas lidhjeve tradicionale, historike, ekonomike dhe sociale. Njësitë administrative në territorin e një bashkie, shtrirja e tyre territoriale dhe emri, përcaktohen me ligj”*; *“Struktura dhe organika e administratës së njësisve administrative janë pjesë të strukturës dhe organikës së administratës së bashkisë”*.

Në rastin konkret, Bashkia Devoll, me qendër në qytetin Bilisht përbëhet nga njësitë administrative: Bilisht, Hocisht, Miras, Progër dhe Qendër – Bilisht, të përcaktuar në ligjin nr. 115/2014, *“Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”*.

Procesi i mbikëqyrjes u realizua sipas programit të mbikëqyrjes të miratuar nga Komisioneri me aktin nr. 304/1prot., datë 25.04.2017, i cili i është njoftuar institucionit me shkresën nr. 304/2prot., datë 25.04.2017, *“Njoftim në lidhje me mbikëqyrjen në Bashkinë Devoll”*.

Në përfundim të këtij procesi, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projekt raportin dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të kontrolluar, me shkresën nr. 304/3 prot., datë 18.10.2017, duke i lënë 15 ditë kohë për të paraqitur observacionet.

Në vijim të procesit dhe në përfundim të afatit që i është përcaktuar institucionit për të paraqitur observacionet përkatëse, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me projekt raportin dhe gjetjet e grupit të punës, ka dërguar projekt raportin e nënshkruar nga personat përgjegjës me shkresën nr. 2660 prot., datë 31.10.2017, *“Kthim përgjigje”*, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 304/4 prot., datë 02.11.2017. Nga përmbajtja e observacioneve rezulton se, subjekti i mbikëqyrur është shprehur dakord me rekomandimet përkatëse për rregullimin e situatës ligjore në institute të ndryshme të ligjit dhe ka pasqyruar disa sqarime në lidhje me rrethanat e parashtruara në projekt raport, të cilat janë trajtuar dhe përfshirë në përmbajtjen e raportit përfundimtar, në kapitujt përkatës.

Për sa më sipër, e vlerësoj si të përmbushur detyrimin për të njohur subjektin me projekt raportin dhe çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij, në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, vlerësoj se është me vend miratimi i përmbajtjes së tij.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, referuar Seksionit III, *“Procedura hetimore”*, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **V E N D O S A:**

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në subjektin, Bashkia Devoll, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin

për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.

2. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Devoll, të marrë masa të menjëhershme për zbatimin e shkresës nr. 5541/20 prot., datë 24.04.2017, të Departamentit të Administratës Publike, “Mbi zbatimin e ligjit nr. 138/2015, dhe të Vendimit nr. 17/16, të Kuvendit të Shqipërisë”, që ka lidhje me garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, lidhur me punonjësin \*\*\*\*\*.  
Njësia përgjegjëse, për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në këtë rast, duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

- ✓ Të rregullojë pasojat duke ndërprerë menjëherë marrëdhëniet e punës së punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin e punës “*Specialist i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Monitorimit të Investimeve në Sektorin e Zhvillimit të Tokës, Mbrojtjes së Mjedisit dhe Monitorimit të Investimeve*”.
- ✓ Të shpallë si të lirë, për ta plotësuar më tej në përputhje me kërkesat ligjore, e në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Devoll, pozicionin në fjalë.

3. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Devoll, të rregullojë pasojat e paligjshmërisë në rastin e procedurës së ngritjes në detyrë për plotësimin e pozicionit të punës, “*Sekretar i Përgjithshëm*”, ku janë lejuar shkelje ligjore, të cilat kanë të bëjnë me faktin se konkurrentja që ka fituar në këtë procedurë, nuk i plotësonte kërkesat e veçanta të vendit të punës.  
Njësia përgjegjëse, për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në këtë rast, duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

- ✓ Të konstatojë menjëherë si akt administrativ absolutisht të pavlefshëm aktin e emërimit, nr. 483, datë 30.06.2016, të punonjësës \*\*\*\*\* në pozicionin e punës “*Sekretar i Përgjithshëm*”, si dhe të gjithë procedurën ligjore për ngritjen në detyrë, të zhvilluar në këtë rast, për plotësimin e këtij pozicioni pune.
- ✓ Të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhëniet e punës me pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm, për punonjësën \*\*\*\*\* dhe të shpallë si të lirë, për ta plotësuar më tej në përputhje me kërkesat ligjore, e në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Devoll, pozicionin në fjalë.
- ✓ Të vlerësojë mundësinë e rikthimit të punonjësës \*\*\*\*\* në pozicionin e punës, në të cilin ajo është deklaruar si nëpunëse civile, nëpërmjet aktit nr. 622/1, datë 15.05.2014, në kategorinë ekzekutive, ku edhe ka punuar përpara konkurrimit.

4. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Devoll, të plotësojë dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil, duke përfshirë në të, të gjitha dokumentet dhe të dhënat sipas lidhjeve 1 e 2, pjesë e vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”, si dhe ato të evidentuara në mungesë në tabelën aneks nr. 2, e cila është pjesë e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

5. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e materializuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

6. Me kalimin e këtij afati, institucioni është i detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
7. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Devoll dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**